



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 73

**Tiranë – E premte, 24 prill 2020**

## PËRMBAJTJA

|                                                                   | Faqe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
|-------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Vendim i Kuvendit<br>nr. 18/2020, datë 23.4.2020                  | Për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore..... 4029                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Akt normativ i Këshillit të Ministrave<br>nr. 17, datë 22.4.2020  | Për përjashtimin e zbatimit të procedurave dhe të afateve për përgatitjen e projektdokumentit të programit buxhetor afatmesëm për vitin 2020..... 4029                                                                                                                                                                           |
| Akt normativ i Këshillit të Ministrave<br>nr. 18, datë 23.4.2020  | Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar..... 4029                                                                                                                                                                                                          |
| Akt normativ i Këshillit të Ministrave<br>nr. 19, datë 23.4.2020  | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar..... 4030                                                                                                                                                                                                       |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 336, datë 23.4.2020       | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të banesave individuale”..... 4030                                                                                         |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 337, datë 23.4.2020       | Për disa ndryshime në vendimin nr.307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rikonstruksionit dhe ndërtimit të infrastrukturës publike, në funksion të rindërtimit të banesave individuale dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”..... 4031 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr.338, datë 23.4.2020        | Për disa ndryshime në vendimin nr.186, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e njësive zbatuese për rindërtimin e shtëpive individuale”..... 4032                                                                                                                                                            |
| Vendim i Komisionit të Ndhmës<br>Shtetërore nr. 97, datë 6.4.2020 | Autorizim i ndihmës shtetërore “COVID-19: skema e garancisë shtetërore të huasë”..... 4032                                                                                                                                                                                                                                       |

**VENDIM  
Nr. 18/2020****PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR  
ZGJATJEN E GJENDJES SË  
FATKEQËSISË NATYRORE**

Në mbështetje të neneve 100 dhe 174, pika 2, të Kushtetutës dhe të shkronjës “d”, të nenit 18, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Dhënie e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, të shpallur me vendimin nr. 243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, deri në datën 23.6.2020.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR  
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 23.4.2020

**AKT NORMATIV  
Nr. 17, datë 22.4.2020****PËR PËRJASHTIMIN E ZBATIMIT  
TË PROCEDURAVE DHE TË AFATEVE  
PËR PËRGATITJEN E  
PROJEKTDOKUMENTIT  
TË PROGRAMIT BUXHETOR  
AFATMESËM PËR VITIN 2020**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:****Neni 1**

Përfshirja për vitin 2020, si pasojë e situatës epidemike të shkaktuar nga COVID-19, procedurat dhe afatet për përgatitjen e projektdokumentit të

programit buxhetor afatmesëm për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të përcaktuara në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nuk zbatohen.

**Neni 2**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR  
Edi Rama**

**AKT NORMATIV  
Nr. 18, datë 23.4.2020****PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA  
NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998,  
“PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”,  
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:****Neni 1**

Në nenin 38 “Dispozita kalimtare”, të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “c”, e pikës 10, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Për tatimpaguesit me qarkullim deri në 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, këstet e parapagimeve të tatim-fitimit të vitit 2020 nuk do të paguhën.”

2. Pas pikës 10 shtohen pikat 11, 12 dhe 13, me këtë përmbajtje:

“11. Përfshirja nga parashikimet e nenit 30 “Parapagimet”, të këtij ligji, për tatimpaguesit me qarkullim mbi 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, këstet e tatimit mbi fitimin për periudhat tatimore të tremujorit të dytë dhe të tretë, prill-qershor dhe korrik-shtator 2020, nuk do të parapaguhën. Pagesat e këtyre kësteve shtyhen në periudhën prill-shtator 2021. Ky përfshirje nuk



zbatohet për tatimpaguesit që zhvillojnë veprimtari ekonomike në fushën e veprimtarisë bankare, të telekomunikacionit, të tregtimit të produkteve farmaceutike, të produkteve ushqimore dhe fruta-perimeve, si dhe tatimpaguesve të listuar në pikën 12, të këtij neni.

12. Përfshihet nga parashikimet e nenit 30 “Parapagimet”, të këtij ligji, kështu e tatimit mbi fitimin për periudhat tatimore prill-dhjetor 2020, për tatimpaguesit që zhvillojnë veprimtari ekonomike në fushën e turizmit e të përpunimit aktiv me material porositësi dhe call center nuk do të parapagohen. Pagesat e këtyre kësteve shtyhen në periudhën prill-dhjetor 2021.

13. Përfshihet nga parashikimet e neneve 13 dhe 13/6, të këtij ligji, dorëzimi i deklaratës vjetore individuale të të ardhurave të vitit 2019 në administratën tatimore dhe pagesa e detyrimit nëse rezulton, bëhet jo më vonë se data 31 korrik 2020.”.

## Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
Edi Rama

## AKT NORMATIV Nr. 19, datë 23.4.2020

### PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9632, DATË 30.10.2006, “PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

Në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

## Neni 1

Në fund të pikës 9, të nenit 27, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Nga pagesa e kësaj takse përfshihen edhe investimet në kuadër të programeve të rindërtimit, sipas dispozitave të ligjit, për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.”.

## Neni 2

Paragrafi i dytë, i nenit 36/1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Përfshihet nga parashikimet e nenit 15, të këtij ligji, pagesat e kësteve të parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin në vitin 2020 nuk do të paguhet.”.

## Neni 3

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
Edi Rama

## VENDIM Nr. 336, datë 23.4.2020

### PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.202, DATË 5.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË BUXHETIN E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 13, pika 3, 16, dhe 36, pika 1, shkronja “a”, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave



## VENDOSI:

1. Në vendimin nr.202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Titulli i vendimit ndryshohet dhe bëhet “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të këtyre banesave”.

b) Pikat 1 dhe 2 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 8 305 346 289 (tetë miliardë e treqind e pesë milionë e treqind e dyzet e gjashtë mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale dhe ndërtimin e rikonstruksionin e infrastrukturës publike si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të këtyre banesave.

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, t’u kalojë njësisë zbatuese, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit në masën 6 465 467 211 (gjashtë miliardë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale brenda dhe jashtë zonave të reja, për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike si dhe e çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim.

b) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi në masën 1 839 879 078 (një miliard e tetëqind e tridhjetë e nëntë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të banesave individuale.”.

c) Pas pikës 2 shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

“2.1 Përdorimi i fondit, i miratuar në buxhetin e vitit 2020, do të jetë 7 573 362 960 (shtatë miliardë e pesëqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, nga të cilat:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm” të programit

06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 5 733 483 882 (pesë miliardë e shtatëqind e tridhjetë e tre milionë e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy) lekësh pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim.

b) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi në masën 1 839 879 078 (një miliard e tetëqind e tridhjetë e nëntë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të banesave individuale.”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

**Edi Rama**

## VENDIM

**Nr. 337, datë 23.4.2020**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.307, DATË 16.4.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT DHE NDËRTIMIT TË INFRASTRUKTURËS PUBLIKE, NË FUNKSION TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE DHE CAKTIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI NJËSI ZBATUESE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me



propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Në vendimin nr.307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i vendimit ndryshohet dhe bëhet “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike, në zonat e reja të shpallura për zhvillim të detyruar”.

b) Pikat 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Përdorimin e fondit të rindërtimit në masën 3 975 401 851 (tre miliardë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë milionë e katërqind e një mijë e tetëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Shijak e Vorë.”.

c) Në pikat 2 dhe 3, vlera “... 1 088 094 042 (një miliard e tetëdhjetë e tetë milionë e nëntëdhjetë e katër mijë e dyzet e dy) lekë pa TVSH ...” ndryshohet dhe bëhet “... 795 080 370 (shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë milionë e tetëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH ...”, miratuar në buxhetin e vitit 2020.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
Edi Rama

## VENDIM

Nr. 338, datë 23.4.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.186, DATË 26.2.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR CAKTIMIN E NJËSIVE ZBATUESE PËR RINDËRTIMIN E SHTËPIVE INDIVIDUALE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “iii”, dhe 16, pika 3, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin

nr.97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Në vendimin nr.186, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Titulli i vendimit ndryshohet dhe bëhet “Për caktimin e njërive zbatuese për rindërtimin e banesa individuale, dhe ndërtimin e rikonstruksionit të infrastrukturës publike”.

b) Pikat 1 dhe 2 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si njësi zbatuese, për rindërtimin sipas projekteve model, të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të banesave individuale jashtë zonave të reja të shpallura në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë, Rogozhinë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak, Vorë.

2. Caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese, për rindërtimin sipas projekteve model, të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të banesave individuale jashtë zonave të reja të shpallura, në Bashkinë Tiranë.”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
Edi Rama

## VENDIM

Nr. 97, datë 6.4.2020

**AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE “COVID-19: SKEMA E GARANCISË SHTETËRORE TË HUASË”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

|                    |          |
|--------------------|----------|
| Znj. Anila Denaj   | kryetar; |
| Znj. Mimoza Dhëmbi | anëtare; |
| Znj. Etleva Haka   | anëtare; |
| Znj. Mirjana Zisi  | anëtare. |
| Z.Ahmet Mançellari | anëtar;  |



në mbledhjen e datës 6 /04/2020, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit””, vlerësoi përputhjen me rregullat e ndihmës shtetërore të skemës së garancisë shtetërore të huas ndërmarrjeve në kushtet e situatës së përhapjes së COVID-19.

Objekti i skemës së ndihmës: Skema synon stimulimin e huadhënies për të mundësuar pagesën e pagave të punonjësve të shoqërive tregtare, veprimtaria e të cilëve është prekur nga masat e ndërmarra nga qeveria në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19.

Baza ligjore e skemës: Draftvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e garancisë shtetërore të huas me bankat e nivelit të dytë për pagat e tregtarëve ose shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është prekur nga vendimet e Këshillit të Ministrave, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19, si edhe për përcaktimin e kushteve e të kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”.

Komisioni shqyrtoi këtë masë me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së skemës së sipërcituar me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar dhe:

#### VËREN SE:

1. Përfitues të ndihmës: Përfituesit final të skemës janë ndërmarrjet e krijuara dhe që funksionojnë në Shqipëri, për të lehtësuar impaktin negativ të krijuar nga përhapja e COVID-19.

2. Vlera e ndihmës shtetërore:

- Buxheti i masës është 11 000 000 000 (njëmbëdhjetë miliard) lekë;

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) merr përsipër të garantojë 100% principalin e Huave, të cilat Huadhënësi do t'i lëvrojë Huamarrësve sipas kushteve të vendosura në Marrëveshjen e Garancisë;

- Vlera e Huasë e vendosur në dispozicion nga bankat për çdo biznes pjesëmarrës mund të variojë në përputhje me kërkesën e paraqitur nga biznesi, por duke mos tejkaluar vlerën e 3 pagave mujore bruto të punonjësve të deklaruar prej biznesit në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi, me

kusht që vlera mujore bruto e pagës për punonjës nuk duhet të jetë më e lartë se 150 000 lekë;

- Termat dhe kushtet e huasë do të përcaktohen në marrëveshjen e huasë, e cila do të nënshkruhet ndërmjet bankës dhe biznesit, në përputhje me marrëveshjen e garancisë.

3. Shtirja sektoriale e skemë: Masa është e hapur për të gjithë sektorët dhe aktivitetet e ekonomisë.

4. Elementet kryesore të ndihmës:

- Kohëzgjatja: Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka të drejtë që, pas 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjeve përkatëse, nëse është e nevojshme, sipas raportit të strukturës së posaçme ndërinstitucionale, i propozon Këshillit të Ministrave rialokimin e shumës së garancisë, nga huadhënësi që nuk e ka ezuaruar shumën e garancisë në favor të tij të huadhënësi që e ka ezuaruar atë plotësisht.

- Garancia do të ofrohet për kreditë e reja të kapitalit punues (pagat);

- Të gjitha garancitë do t'i nënshtrohen kushteve të përcaktuara në një marrëveshje garancie, duke përcaktuar kushtet ligjore që lidhen me aktivizimin e garancisë. Marrëveshja e garancisë do të nënshkruhet nga MFE dhe secila nga bankat tregtare. Marrëveshja e garancisë do të ketë në aneks të saj marrëveshjen e mirëkuptimit, e cila do të përmbajë kushtet sipas marrëveshjes të garancisë. Nënshkrimi i marrëveshjes së mirëkuptimit nga bizneset do të jetë kusht për kualifikimin e huasë në skemën e garancisë;

- Huadhënësi do të ofrojë Huanë me një normë interesi preferenciale, të barabartë me normën mesatare të interesit të tre ankandeve të fundit të bonove të thesarit 12 mujore plus një marzh prej 0.5%, por në asnjë rast norma e interesit nuk do të jetë më e lartë se 2.85%.

5. Kumulimi i ndihmës: Në këtë skemë nuk përfshihen tregtarët ose shoqëritë tregtare, të cilat para miratimit të tij janë subjekt i përfitimit nga skema e subvencionimit të pagës sipas VKM nr. 254, datë 27.3.2020 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike dhe të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasoje e COVID-19”.



6. Monitorimi dhe raportimi: Për monitorimin, shqyrtimin dhe raportimin pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në lidhje me ecurinë e garancisë shtetërore, do të angazhohet një strukturë e posaçme, e cila do të miratohet me urdhër nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë.

7. Ekzistenca e ndihmës shtetërore: Në kuptim të nenit 4 të ligjit për ndihmën shtetërore, skema përbën ndihmë shtetërore, duke qenë se:

- Skema aktivizon burime shtetërore, duke qenë se do të administrohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

- Skema i jep një avantazh përfituesve të saj në formën e garancive për kredi, duke i lehtësuar nga kostot që do të duhej të mbartnin në kushte normale të tregut.

- Skema është selektive, duke qenë se jepet vetëm për disa ndërmarrje.

- Skema do të zbatohet në sektorë dhe ndërmarrje përfituese, të cilët janë aktivë në sektorët në të cilët ekziston tregtia ndërkombëtare.

Sa më lart, Komisioni i Ndihmës Shtetërore në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar vlerëson se garancia shtetërore që do të lëshohet në favor të secilës prej bankave të nivelit të dytë, nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjes së garancisë mes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe bankave të nivelit të dytë për pagat e bizneseve, aktiviteti i të cilëve është prekur nga vendimet e qeverisë në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19, si dhe marrëveshjes së mirëkuptimit, e cila do të nënshkruhet nga secili biznes që do të marrë kredi, përfshihet në rastet e

parashikuara ndryshe në këtë ligj, dhe përbën ndihmë shtetërore, e cila është e lejueshme në bazë të shkronjës b), të nenit 13, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, e cila jepet për të mënjeluar gjendje të rënda në ekonominë e vendit të shkaktuar nga COVID-19.

#### PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të shkronjës të shkronjës b) të nenit 13, shkronja a), të nenit 17, nenit 22, 30 dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar:

#### VENDOSI:

1. Të autorizojë zbatimin e skemës së ndihmës shtetërore të parashikuar në draftvendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e garancisë shtetërore të huas me bankat e nivelit të dytë për pagat e tregtarëve ose shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është prekur nga vendimet e Këshillit të Ministrave, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19, si edhe për përcaktimin e kushteve e të kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”, sepse ndihma jepet për të përballuar efektet e fatkeqësisë natyrore, e shkaktuar nga COVID-19.

2. Ministria e Financave dhe Ekonomisë të raportojë pranë Komisionit të Ndihmës Shtetërore të dhënat mbi zbatimin e skemës.

3. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Anila Denaj

|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 84 lekë